

horizonte

Për një jetë me dinjitet për të gjithë njerëzit!

Sektori i tregtisë me pakicë

Kërkohe KKP për gjitha firmat!

2

Mësimi i gjuhës e kulturës amtare

Të vlerësohet arsimit dhe shumëgjuhësia!

3

Përmbyllja e pagave 2015

Të arritura në sektorë të caktuar

4

Nr. 1 | mars 2015 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kongresi i migrantëve e migrantëve dhe njerëzve me sfond migracioni

Të drejta të njëjta për të gjithë migrantët/et



Pamje e delegatëve në Kongres duke votuar për rezolutat e propozuara

Rreth 260 pjesëmarrës iu përgjigjën ftesës kundër racizmit dhe ksenofobisë. Përmes Kongresit të parë të migrantëve e migrantëve dhe njerëzve me sfond migracioni synohet që migrantët të ngritin zërin dhe të kërkojnë të drejtat e tyre. Delegatët përmes katër rezolutave kërkuar të drejta të njëjta për migrantët/ët, solidaritet me refugjatët, rregullimin e statutit për personat pa letra, të mos dëbohen bashkëqytetarët, të cilët pikë qëndresën e jetës së tyre e kanë këtu. Kongresi pos tjerash aprovi një manifest.

Kongresi i ftuar nga sindikata Unia dhe organizatat Second@s plus dhe Federazione Colonie Libere Italiane (FCLI) si dhe Fabbrica di Zurigo dhe Marea Granate u mbajt më 7 shkurt 2015 në Bernë Për shkak edhe të tendencave ksenofobe në rritje në politikën zvicerane, organizatorët theksuan nevojën e një lëvizjeje politike, e cila do të fuqizojë të drejtat e migrantëve/ëve dhe njerëzve me sfond migracioni dhe e cila lëvizjeje do të ngrejë zërin kundër diskriminimit. Kongresi u hap nga Halua Pinto de Magalhães, përfaqësues i Organizatës Second@s plus dhe më pastaj pjesëmarrësit u përshëndetën nga Co-Presidentja e Unia-s, Vania Alleva, e cila gjithashtu është Secondas.

Fjalime tematike dhe rezolutat

I pari foli Kijan Espahangizi nga Second@splus të Zvicrës dhe njëherit edhe anëtarë i grupit përgatitor të Kongresit, mbi temën «Një vit pas aprovimit të iniciativës së migrimit masiv». Personat dhe organizatat pjesëmarrëse kërkuar respektimin e lëvizjes së lirë të personave me Bash-

kimin Evropian. Ata refuzuan qartas kontingjentet diskriminuese të migrantëve dhe rikthimin e statutit të sezonierëve: Të gjithë/a migrantët/et, të cilët jetojnë në Zvicër, duhet të gëzojnë parakushte të njëjta në tregun e punës dhe të kanë të drejtën e patjetrësueshme për bashkim familjar.

Pas tij foli Balthasar Glättli nga Partia e Gjellbër të Zvicrës. Ai bëri një hyrje në rezolutën e parë «Azili dhe refugjatët janë imperativ humanitar». Pjesëmarrësit mbështetën kërkesën për pranimin në afat sa më të shkurt të 100000 refugjatëve nga Siria.

Amanda Loset nga Solidarité Sans Frontières, prezantoi Rezolutën e dytë «Asnjë njëri nuk është ilegal». Rezolutën e tretë «Të drejta të njëjta për të gjithë migrantët/ët» e paraqiti Amílcar Cunha, sekretare sindikale e Unia-s. Me këto rezoluta u kërkuar rregullarizimi (legalizimin) e statutit të qëndrimit për të gjithë personat «pa letra» që jetojnë në Zvicër, rritje të numrit të lejeve të punës për punëmarrësit nga shtetet e treta (ku hyjnë edhe shtetet tona amë, si Shqipëria, Kosova, Maqedonia, ...) dhe ndaljen



Pjesëmarrje laramane në Kongres



Fjalë përshëndetëse në Kongres

e dëbimit e njerëzve, të cilët janë lindur apo që janë socializuar në Zvicër.

Jo-Pegida në Zvicër

Duka pasur parasysh faktin se edhe në Zvicër është lajmëruar Pegida, organizatorët Kongresit kishin ftuar Florian Illerhauser, një aktivist ky i Lëvizjes anti-Pegida nga Leipzigu, dhe njëherazi përfaqësues i Rrjetit kundër Islamofobisë dhe Racizmit në Leipzig. Mysafiri nga Gjermania referoi mbi zhvillimet dhe pëvojat mobilizuese përkitazi me manifestimet anti-Pegida në Leipzig. Pas Illerhauser-it bashkëkombësja jonë Shpresa Jashari nga «Zvicra e migruar» («Bewanderte Schweiz») foli për temën e ksenofobisë. Ajo më pas prezantoi materialin për diskutim mbi temën e racizmit.

Përzjerje e mirë

Për herë të parë në Zvicër u takuan bashkë migrantët/ët dhe njerëzit me sfond migracioni, organizatat e migrantëve/ëve të «ri» – kryesisht të arsimuar/a mirë, të cilët/at janë të punësuar/a në profesionet e shërbimeve – si, politikan/e dhe persona-

litete me sfonde të ndryshme migracioni, pastaj ata nga «Fabbrica di Zurigo» und «Marea Granate», refugjatë, persona «pa letra», punëmarrës e sindikalistë dhe të punësuar në pozita të larta, të gjithë bashkërisht për të krijuar një forcë të përbashkët politike kundër përjashtimit dhe ksenofobisë.

Puna vijon më tej

Në disa grupe pune delegatët e Kongresit shqyrtuan dhe aprovuan manifestin, i cili paraqet dokumentin bazë i cili do të shërbejë për punë të mëtejme të përbashkët. Pjesëmarrësit/it e interesuar patën rastin të regjistroheshin në katër grupe pune, të cilat do të fillojnë punën e tyre pas kongresit. Gjithashtu një grup koordinuese, i përbërë nga përfaqësues të grupeve e organizatave u autorizua të përpunojë strukturën dhe aksionet e ardhshme.

Kongresi i parë i migrantëve e migrantëve dhe njerëzve me sfond migracioni në Bernë ishte një sukses. Ky sukses paraqet hapin e parë në drejtimin e duhur.

Osman Osmani

Editorial



Më 15 janar tre meshkuj të Drejtorisë së Bankës Kombëtare Zvicerane (BKZ) vendosën që të mos mbështesin edhe më tej normën minimale të këmbimit prej 1.20 franga për një euro. Menjëherë pasoj fuqizimi i frangut zviceran dhe për një kohë një frang mund të këmbëhej me një euro. Për klientët dhe konsumatorët nga hapësira e BE-së domethënë se ata duhet të paguajnë 20% më shumë për produktet zvicerane apo për pushime në Zvicër. Për industrinë e eksportit dhe turizmin kjo situatë paraqet një sfidë, pasi ata ose duhet të ulin çmimet apo të llogaritin me më pak të hyra, deri edhe në humbjen e myshterinjve.

Disa ndërmarrje menjëherë kanë bërë të njohur masat që duan të ndër marrin, si ulja e pagave, zgjatjen e orarit të punës dhe shkakime nga puna. Unia kundërshton vendosmërisht këto masa. Nuk duhet të jenë punëmarrësit ata, që duhet të bartin pasojat e fuqizimit të frangut: ndërmarrjet që planifikojnë ndërmarrje të masave, duhet të dinë se është e ndaluar pagesa e pagave me euro punëmarrësve kalimtarëve të përtej kufirit. Në shumë ndërmarrje prodhuese kostoja e pagave paraqet vetëm 20% të të gjitha shpenzimeve, andaj ulja e pagave nuk paraqet kurrfarë kursimi të shpenzimeve. Zgjatja e ararit të punës dëmtojnë mjedisin e punës dhe nuk përmirësojnë asgjë. Nëse mungojnë mandatet për punë, ndërmarrjet do të duhej të ulnin orarin e punës, një masë e dobishme e sigurimit të papunësisë.

Synim me rendësi është që BKZ ka marr prapë përsipër përgjegjësinë për vendin. Ajo është e obliguar nga ligji të kujdeset për stabilitet të çmimeve dhe me këtë rast të merr në konsideratë ekonominë dhe punësimin. Unia bashkë me partnerët social do të angazhohet, që BKZ përsëri të kujdeset për normën korrekte e të qëndrueshme të këmbimit të frangut. Mirëpo Unia do të propozojë edhe masa tjera, nëse nuk reagon BKZ.

Beat Baumann

Ekonomist i sindikatës Unia

News

Kujdes: Mashtrim nga ana e sindikatës të shefave «Novatrava»

Një sindikatë, e krijuar nga vet shefat? Kjo nuk është një shaka. Kua-dri i firmave të ndërtimtarisë dhe i shoqatës së punëdhënësve të ndërtimtarisë me ndihmën e përfaqësuesve të punëdhënësve duan të themelojnë një sindikatë. Arsyeja është bisedimet e sivjetme për ripërtëritjen e Kontratës Kombëtare të Punës, e cila rregullon kushtet e punës në sektorin e ndërtimtarisë. Sindikata e re e shefave bëhet sikur angazhohet për punëtorët e ndërtimtarisë. Në të vërtetë tregohet e gatshme të përkeqësojë kushtet e punës, të ulë pagat minimale, bile edhe të atakojë pensionimin më 60 vjet. Ata duan tua mbushin mendjen për anëtarësim shumë punëtorëve në sindikatën e tyre. Ndaj: Kujdes dhe duart larg nga ky mashtrim! Dhe gjithsesi lajmëroni ese vëreni aktivitete të kësaj organizate.

Rinia e Unia-s – Ndhimja për zhvillim ndërkombëtar



Rinia e Unia-s Biel-Seeland / Kantoni Solothurn kontribuon konkretisht për solidaritetin ndërkombëtar. Një ekip mjeshtrësh e zejtarësh prej 10 veshash i rinisë së këtij regjioni të sindikatës Unia para ndërrimit të mot moteve udhëtoi për në Nikaragua, ku ndërmorën një riparim të gjithanshëm në shkollën e atjeshme profesionale të sindikatës së punëtorëve bujqësor ATC. Për angazhimin tre javorë vullnetar në San Marcos kërkohet aftësi zejtare dhe motivacion i madh. Angazhim i madh është nevojitur edhe në dy javët parapërgatitore të projektit, posaçërisht për sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare. Më shumë informata mund të gjeni në: biel-solothurn.unia.ch/de/news/artikelansicht/a/10557/

Mbështetje ndërkombëtare për punonjësen e Lindematte-s

Njerëzit nga e tërë bota tanimë kanë treguar solidaritet me Kathrin Schmid. Ajo ishte anëtare e komisionit të punonjësve. Dhe anëtare aktive e sindikatës dhe për këtë arsye në nëntor 2014 është shkarkuar nga puna nga Shtëpia e përkujdesjes së pëlqevenga Lindenmatte: Edhe ju keni mundësi të dërgoni E-mail protestues përmes vegës vijuese në internet: gutepflege.ch/2014/12/16/lindenmatte-protestmail-senden/

Tregtia me pakicë

H&M paguan rishtas 22 franga në orë



Shitëset qeras nga Unia me kuleçtë tradicionalë dhe kurora

Nga fillimi i këtij viti shitëset/it e H&M për një orë pune marrën më së paku 22 franga. Për të njoftuar mbi këtë hap pozitiv, sindikata Unia me rastin e ditës së pagëzimit ka shkuar nëpër filiale të shumta dhe ua ka shpërndarë personelit shitës kurora dhe ëmbëlsira.

Shumë ndërmarrje që tregtojnë me pakicë në rrjedhën e kampanjës sindikaliste për paga minimale kanë rritur pagat e tyre. Kështu ndër të tjera rrjeti i madh i modës suedeze H&M duke filluar nga 1 janari 2015 për të gjithë personelin ka përcaktuar pagën minimale prej 22 frangave në orë. Kjo tregon se në tregtinë me pakicë në Zvicër janë të mundshme pagat korrekte.

Unia përshëndet rritjen e pagave dhe kërkon KKP për firmat

Për të përmirësuar kushtet e punës tek H&M Unia kërkon negociata për një Kontratë Kolektive të Punës (KKP) për këtë ndërmarrje. Pasi tek kushtet e punës në H&M përkundër kësaj rritje të pagave ka nevojë edhe për hapa tjerë, tregon edhe studimi i publikuar rishtas «Kushtet e punës në sektorin e tregtisë me pakicë 2014».

Aksioni me rastin e ditës së pagëzimit

Me rastin e ditës së pagëzimit më 6 janar, Unia u ka dorëzuar personelit shitës të H&M kuleçtë tradicionalë dhe kurorën speciale si dhe i ka falënderuar ata për punën e përditshme. Mbetet për të shpresuar, se deh ndërmarrje tjera do të ndjekin shembullin e H&M dhe se përmes pagave më të mira do të investojnë për personelin e tyre. Pasi për tregtimin me pakicë, si sektor që ka të bëjë me myshterijnë dhe kualitet, të punësuarit janë faktori kryesor për suksesin e ndërmarrjes.

Osman Osmani



Unia mbështet kërkesa



Në aksion para firmës H&M



Ekonomia e Kosovës

Shteti si pronar i kombinatit «Trepça»

Ndërrimi i pronësisë së kompleksit «Trepça» nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) tek ekzekutivi, hap një epokë të re për këtë kompleks, faktikisht përmirësohen gabimet e bëra para 14 vjetësh, kur padrejtësisht Trepça është futur nën menaxhimin e AKP-së.

Kështu vlerëson Halil Qela, ushtrues detyre i drejtorit gjeneral të kompleksit «Trepça», pas inicimit të qeverisë që kompleksi «Trepça» të kalojë në ndërmarrje publike. Ndërmarrjet publike janë në pronësi të shtetit dhe qeveria është kompetente për caktimin e bordit që do të udhëheqë këtë ndërmarrje. «Prej këtu përfundon status-quo e shumë viteve të kaluara dhe një humbje shumë e madhe edhe e tregut edhe në aspektin teknologjik edhe në aspektin e konkurrencës. Tash hapen perspektivat qoftë për financim nga Qeveria e Kosovës, qoftë për bashkëpunim publiko-privat me kompanitë e interesuara, qoftë marrje kredish», ka thënë Qela për Radion Evropë e Lirë.



Nga protesta e fundit e minatorëve



Hyrja në minierën e Trepçës

Qeveria e hamendshme

Në qeveri tashmë ka kaluar koncepti i dokumentit mbi amendamentin e Ligjit të ndërmarrjeve publike në të cilën do të trajtohet edhe «Trepça». Zyrtarë të qeverisë besojnë se në muajin shkurt ligji më amendamente për ndërmarrjet publike do të kalojë në Kuvend, ku Trepça do të hyjë në listën e ndërmarrjeve publike. Sidoqoftë, edhe në një plan të vitit 2002 të përgatitur nga menaxhmenti i atëhershëm i Trepçës, është

konstatuar se zgjidhja më e mirë për kombinatin është që të shndërrohet në ndërmarrje publike, thotë ish-drejtori i «Trepçës», Nazmi Mikullovci. Shteti si pronar, thotë ai, me politika të caktuara, «Trepçën» mund të shndërrojë në shtyllë të madhe të zhvillimit ekonomik më investime private. «Sa i përket për një zhvillim të mëtutjeshëm, nëse dëshirojmë të kemi një industri përpunuese, ku do të bien teknologji të reja bashkëko-

hore, të bëhet punësim dhe kapital i huaj do të vjen, aty dikush duhet të ofrojë një garanci dhe siguri për furnizim me metal».

«Në qoftë se bëhet privatizimi i minierave, minierat privatizohen jo për profit, por për shkak të koncentratit. Metalurgjia që ndërtohen, ndërtohen për shkak të metalit. E ne duhet t'i shfrytëzojmë metalet për finalizim, aty ku është edhe profiti edhe mundësia e zhvillimit teknik-teknologjik», shprehet Mikullovci.

Potencial i madh ekonomik

Ndryshe, për aktivizimin e «Trepçës», Halil Qela, thotë se nevojiten deri në 350 milionë euro investime, duke përfshirë këtu edhe rregullimin e çështjes sociale të punëtorëve. «...ish punëtorët tonë të cilët nuk kanë pasur mundësi që të përfshihen

në punë, të mbulohen më pensione të merituar. Po ashtu edhe në miniera të bëhet modernizimi, modernizimi i flotacioneve, metalurgjisë dhe industrisë kimike».

«Do të thotë, e tërë kjo shifër do të mbulonte të gjitha këto, më çmime aktuale. Kjo shifër ka ndryshuar vit pas viti. Në llogaritjen e parë që është bërë, janë nevojitur 170 milionë euro, kurse tashmë ka kaluar në 350 milionë euro në mungesë të investimeve dhe pritjes kaq të gjatë», thotë Qela.

Aktualisht gjiganti metalurgjik «Trepça» që gjendet në Mitrovicë, është nën moratoriumin e vendosur nga Dhoma e Posaçme Supreme, ndërsa Agjencia Kosovare e Privatizimit është administrator i saj.

Nadie Ahmeti, Radio Evropa e lirë, 31.1.2014

Kosovë, miratohet në parim ligji për ndërmarrjet publike

Pas gati 9 orë debati, Kuvendi i Kosovës miratoi në parim propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndërmarrjet publike.

Me 48 vota pro, 22 kundër, siç kishte paralajmëruar opozita dhe 1 abstenim, ky projektligj që pritet të sqarojë të ardhmen e kombinatit u kalon komisioneve për ndryshime.

Pikërisht neni 3 i projektligjit për ndryshimin e ligjit për ndërmarrjet pu-

blike, i cili u jep të drejtë komunave të vendosin për të ardhmen pronësore të pronave shoqërore përplasi pozitën dhe opozitën. Shumica parlamentare e kritikoi nenin dhe premtoi ndryshim të tij në komisione, opozita kërkoi heqjen e tij dhe akuzoi qeverinë se ky nen ka ardhur si pasojë e shantazheve të Serbisë.

Përgaditi dhe përshtati: Osman Osmani, sekretar sindikal për migracion Top Channel, 13.2.2015

E ardhmja e mësimi plotësues në gjuhët e migrantëve

Broshura kërkon vlerësimin e shumëgjuhësisë të fëmijëve të migrantëve

Një numër i shkollarëve të Zvicrës rriten me dy apo më shumë gjuhë. Në të ashtuquajturat kurse të gjuhës dhe kulturës amtare (shkurtesa në gjermanisht: HSK-Kurse) fëmijët kanë mundësi të konsolidojnë dhe zgjerojnë gjuhën e prindërve të tyre. Kjo është shumë me rëndësi për formimin e identitetit të tyre dhe për të rritur shanset e këtyre fëmijëve. Mirëpo mësimi i gjuhës amtare zhvillohet shpesh në kushte shumë të vështira.

Shumë fëmijë vijojnë mësimin plotësues në gjuhën amtare që zhvillohet në disa gjuhë. Vetëm në Kantonin e Cyrihut aktualisht janë rreth 10000 nxënës e nxënës në 26 gjuhë të ndryshme: në gjuhët zyrtare vendore italisht e frëngjisht, në gjuhët ndërkontinentale si spanjisht, kinezisht apo portugalisht dhe gjuhët më të vogla si ajo shqipe, finlandeze e kurde. Megjithatë shanset që, njohurit poseduese të gjuhëve ndërkombëtare të zgjerohen dhe të zotërohen në një nivel më të lartë, sikur edhe në shumë vende tjera përjetojnë trajtim njerke.



Broshura si rezultat i Simpoziumit

Për të diskutuar kushtet nën të cilat zhvillohet mësimi plotësues në gjuhën amtare, Bashkësia e Interesit të gjuhëve të para (në tekstin e mëtejme shkurtesa në gjermanisht: IGE), të cilës i takon edhe Unia, në janar të vitit 2014 organizoi simpoziumin «E ardhmja e mësimi plotësues të gjuhës amtare në Zvicër: sigurimi i kualitetit, zhvillimit të mëtejme dhe të integritetit». Në te morën pjesë rreth 200 profesionistë. Si rezultat përmbledhës të tij IGE ka publikuar broshurën «E ardhmja e mësimi të gjuhëve të para». Kjo broshurë prezanton një «katalog kërkesash» të rëndësishme për zhvillimin e mëtejme, integrimin në sistemin e rregullt shkollor dhe për sigurimin e kualitetit të HSK-Kurseve (mësimi i gjuhës dhe kulturës amtare).

Lista e kërkesave

Kështu organizatorët treguan se si duhet të zhvillohet më tej mësimi në gjuhën amtare. Qëllimi i mësimi do të duhet të ishte, cjtja e zhvillimit të identitetit shumë-gjuhësor të fëmijëve. Për tu arritur kjo, organizatorët kërkojnë ndër tjera përmirësimin e infrastrukturës në objektet



Pjesëmarrëset gjatë punëtorive në seminarin



Pamje gjatë punimeve të seminarit

shkollore, masa pragmatike dhe fleksibile kundër izolimit të mësimi të gjuhës amtare, bashkëpunim i institucionalizuar mes mësimdhënësve të gjuhës e kulturës amtare dhe mësimdhënësve të shkollimit të rregullt, më shumë mundësi trajnimit të mëtejme për mësimdhënësit e gjuhës amtare, kushte të njëjta pune për të gjithë, si dhe integrim të këtyre kurseve në sistemin shkollor publik.

Arsim për të gjithë: Shumëgjuhësia

Përmes këtij publikimi IGE-ja angazhohet që, të vlerësohet e përmirësohet mësimi në gjuhën amtare si dhe të perceptohet si një përgjegjësi e ankoruar qendrore e arsimit publik. Për IGE e ardhmja e shkollimit publik – që zbaton të drejtën e të gjithëve në arsimim – është në shumë-gjuhësinë. Gjuhët e para të fëmijëve të migrantëve nuk do të duhet të marginalizohen edhe më tej. Ato për më tepër



Shumëgjuhësia duhet të integrohet në sistemin e shkollimit publik

do të duhet të garantoreshin si pjesë integrale dhe kualitative të sistemit shkollor publik.

Peticioni mbi mësimin e gjuhës amtare

Në Kongresin e parë të migrantëve e migrantëve të mbajtur më 7 shkurt 2015 në Bernë u iniciua edhe një peticion mbi kurset e mësimi të gjuhës dhe kulturës amtare. Shkresat e peticionit për nënshkrim mund të porositni në adresën elektronike migration@unia.ch.

Osman Osmani

Informata të mëtejme mund të gjeni në:

www.linguaprima.ch/index.php?id=8

Broshurën «E ardhja e mësimi të gjuhëve të para» mund ta porositni falas në: migration@unia.ch

Pagat dhe frangu i fortë

Pagat në euro janë ilegale



Unia e Zvicrës veriperëndimore ka reaguar në vendimin e ndërmarrjes Straumann AG që kaluesve të kufirit t'ua paguajë rogat me euro, përmes një shkresë drejtuar kësaj ndërmarrjeje medicinale. Ajo lut drejtorinë që vendimin e saj ta tërheq deri nesër.

Ndërmarrja medicinale Steumann u «ofron» punonjësve/eve kalues/e të kufirit dhe të punësuarve tjerë të saj, që pagat tua paguajë në euro. Unia dënon këtë veprim. Si shkëmbim Unia lut drejtorinë, të heq dorë nga fitimi.

Pagat në euro janë ilegale

Unia refuzon reduktimet e pagave në parim. Rreziqet e ndërmarrjeve, ky hyjnë edhe luhatjet e monedhës, nuk guxojnë tu vihet në barrë punëmarrësve.

Gjyqi kantonial i Listal-it qysh në vitin 2012 në rastin Stöcklin ka vendosur, që pagat në euro për punëmarrës

përtej kufirit nuk janë të ligjshme, pasi që përpos që diskriminojnë janë në kundërshtim edhe me lëvizjen e lirë të personave.

Straumann-it i shkojnë punët për mrekulli

Straumann qysh në vitin që lamë pas arriti ti rritë fuqishëm të hyrat dhe rendimentet. Me këtë rast kjo ndërmarrje përfiton edhe nga rënia negative e efekteve të monedhës. Që tani punëmarrësit të rrjepën për krijën e tanishme të monedhës, është e pakuptueshme dhe e papranueshme.

Osman Osmani

Zbatimi i iniciativës mbi migrimin masiv

Unia kundërshton diskriminimet e reja

Sindikata Unia refuzon propozimin e qeverisë federale mbi implementimin e iniciativës mbi migrimin masiv (MEI). Unia vazhdon të qëndron pas kërkesave të saja për një zbatim të ekuilibruar e të arsyeshëm për të gjithë punëmarrësit dhe pa kontingjente diskriminuese.

Qendrore në qasjen ndaj implementimit të iniciativës mbi migrimin masiv duhet të jetë sigurimi i marrëdhënies bilaterale me BE-në. Andaj, Unia është e befusuar që qeveria federale paraqesë një kundërpropozim

legjislativ, para se të ketë negociuar paraprakisht me BE-në. Pos kësaj duhet të garantohej mbrojtja e pagave dhe e kushteve të punës në Zvicër. Është e papranueshme në propozimin legjislativ posaçërisht Neni 22,



Rrezikohen marrëdhëniet bilaterale

Pika 2, sipas të cilës tek mungesa e kuadrit profesionale lihen anash në masë të madhe kontrolli i pagave dhe kushteve të punës. Kjo i hap rrugë keqpërdorimeve.

Pa diskriminime të reja

Për sindikatën Unia, me rastin e zbatimit të iniciativës mbi migrimin masiv, qendrorë është eliminimi i mundësive të futjes së diskriminime të reja karshi punëmarrësve. Implementimi duhet të jetë i akorduar me marrëveshjen për lëvizjen e lirë të personave, për të mos rrezikuar marrëdhëniet bilaterale me BE-në. Në veçanti nuk duhet të preket e drejta e migrantëve/ëve për bashkim familjar.

Osman Osmani



Pllakatet që paraqesin ndarjen edhe në shoqërinë zvicerane

Përmbyllja e pagave 2015

Të arriturat në degë e caktuara ekonomike

Sektorët	Firmat	Rritjet	Rritjet e përgjithshme	Rritjet individuale	Vërejtjet shtesë
Industria e MEM	Bombardier Transport, Villeneuve (VD)	1%	2%	-	Përgjithësisht Fr. 50.-
	EWB, Bern	1,1%	0,7%	0,4%	
	LN Industrie SA	1%	0,5%	0,5%	
	Sia Abrasives, Frauenfeld	1%	-	1%	
	Schindler, Ebikon (LU)	1%	-	1%	
	Siemens	3%	1,2%	1,8%	Përgjithësisht Fr. 100.- Rritja ka hyrë në fuqi qysh në prill, e negociuar për dy vite
	Industria e përpunimit të pjesëve të makinave	-	-	-	Rritje e pagës minimale për Fr. 100 (x13)
Industria e Ndërtimit	Ndërtimtaria kryesore	-	-	-	S'ka negociatë
	Industria e tullave CH	0,8%	0,8%	-	Përgjithësisht Fr. 40.- Rritje e pagës minimale për Fr. 25.-
	Industria e betonit	0,3%	-	0,3%	Rritje e pagës minimale për Fr. 50.- në 13 x Fr. 4000.-/4100.-
Kimia	Cilag, Schaffhausen	1%	-	1%	
	Johnson Controls	1%	-	1%	
	Novtatis, Basel	1,8%	-	1,8%	Baza e garantuar prej 0,85%
	Roche Basel/ Keiseraugust	1,4%	-	1,4%	
	Siegtiedler, Zofingen	1%	-	1%	Plus shtrenjëtimi
	SI Group	1,2%	-	1,2%	
Industria ushqimore dhe ajo shijuese	Camille Bloch, Courtelary BE	1%	1%	-	
	Feldschlösschen, Rheinfelden AG	0,8%	-	0,8%	KKP e re
	Lindt & Sprüngli	1,25%; 1%	1,25%; 1%	-	Plus 1,25% për pagat nën Fr. 5000.-: 1% mbi 5000.-
	Salines de Bex (VD)	0,9%	0,9%	-	Kompenzim Fr. 500.- tek pagat nën Fr. 500.-
	Ucifa	1% (përafërsisht, res. vlera të pëafërta)	-	-	Përgjithësisht Fr.50.- Ngritje e pagave minimale për Fr. 75.- në 3850.- (2%)
Ekonomi ndërtimi dhe zejtari	Elektricitetë/ telekomunikim/ zeje instaluese	1,9% (përafërsisht, res. vlera të pëafërta)	-	-	Rritje prej Fr. 100.- për të gjitha kategoritë
	Tavanpunues dhe ndërtim sistemesh të brendshme	0,8%	0,8%	-	
	Zeja izoluese	-	-	-	Pagesë e njehershme Fr. 360.-
	Zeja e përpunimit të metaleve	0,6%	0,6%	-	Përgjithësisht Fr. 30.-
	Zeja e makinave AG	2%; 1,25%	2%; 1,25%	-	Përgjithësisht Fr. 100.- për të kualifikuarit nën Fr. 5000.- përgjithësisht Fr. 50.- për të pakualifikuarit nën Fr. 5000.-
	Zeja e makinave BS, BL	0,5%	-	0,5%	Rritje e pagës minimale për Fr. 20.- (0,4%)
Terciar	Pastrimi në Zvicrën gjermane	-	-	-	Ngritje e pagave minimale prej 1% deri 2,5%
	Pastrimi në Zvicrën frankofolëse	-	-	-	Ngritje e pagave minimale për Fr. 65.- deri Fr. 75.- (1,3% - 2,2%)
	Elvetino	1,3%	1,3%	-	Përgjithësisht Fr. 50.- Ngritje e pagave minimale Fr. 25.- (0,6%)
	Floktari CH	-	-	-	Ngritje e pagave minimale Fr. 100.- tek Fr. 3700.- (2,8%) nga shtatori 2014
	Coop CH	1%	1%	-	Ngritje e pagave minimale për të pakualifikuar për Fr. 50.- (x 13) për të kualifikuar për Fr. 100.- (x 13)
	Migros	0,7% - 1,2%	-	0,7% - 1,2%	Ngritje e pagave minimale për të pakualifikuar dhe të kualifikuar për Fr. 100.- (x 13)



Ju pyesni, Unia përgjigjet

Shkarkimi nga puna: A lejohet një periudhë e punës provuese 4 muaj?

Në fillim të dhjetorit 2014 kam filluar punën si shitëse në një shitore të vogël të prodhimeve të qumështit. Mes shefit tim dhe meje pandërprerë kishte mospërputhje. Më 28 shkurt 2015 shefi im me përmes shkresës dorëheqëse më largoj nga puna. Mirëpo shtresës e dorëheqjes unë e kam pranuar përmes postës tek më 3 mars 2015. Në letër qëndron se afati i dorëheqjes është 7 ditë, pasi unë jam ende në periudhën provuese të punës. Kjo zgjat 4 muaj, kështu qëndron në kontratën time të punës. A duhet të pajtohem unë me këtë afat shkarkimi?

Jo, nuk duhet të pajtoheni. Pasi periudha e juaj provuese e punës ka përfunduar më 3 mars 2015. Këtë për arsyt vijuese: Si periudhë provuese e punës në parim vlen muaji i parë i marrëdhënies në punë. Përmes një Kontrate të veçantë me shkrim, Kontrata Normale e Punës apo Kontrata Kolektive e Punës (KKP) partnerët kontraktues mund të zgjasin periudhën e punës provuese deri në më së shumti 3 muaj (neni 335 b i së drejtës së detyruar). Periudha 4 mujore provuese e punës pra nuk është e ligjshme. Andaj për ju vlen periudha 3 mujore provuese e punës. Shefi juaj ju ka shkarkuar në ditën e fundit të periudhës (tremujore) provuese të punës. Mirëpo përcaktuese është kur e keni pranuar shkresën e dorëheqjes. Pra jo data kur është dërguar apo shkruar dorëheqja. JU keni pranuar shkresën nga posta më 3 mars 2015, pas kalimit të afatit të periudhës provuese të punës. Afati i shkurtë 7 ditësh pra nuk vlen për ju. Nëse nuk ka marrëveshje tjetër me shkrim, apo nëse nuk qëndron në KKP, atëherë afati i shkarkimit në vitin e parë të punës zgjat një muaj. Marrëdhënia e juaj e punës përfundon tek në fund të prillit.

Peter Schmid, work, 23.1.2015

(AHV-)Pensioni i pleqërisë: Merr bashkëshortit ende shtesat e fëmijëve?

Unë në mars mbushi 65 vjet dhe përfundoj marrëdhënien time të punës. Bashkëshortja imë është 4 vjet më e re se unë. Ajo edhe më tej punon 50%. Vajza jonë më e reja është 23 vjeç dhe ende në arsimim. Nga sigurimi pensional i pleqërisë (AHV) kam marrë lajmërimin që përpos pensionit tim të pleqërisë, edhe vajzës sime do ti paguhet një pension fëmijësh. A merr megjithatë gruaja ime shtesat familjare?

Po. Shtesat familjare dhe pensioni i fëmijëve nuk përjashtojnë njeri tjetrin. Nëse tek ju janë plotësuar parakushtet ligjore për ju dy, atëherë ju merrni të dyja përfitimet. Ligjdhënësi shprehimisht kanë vendosur kështu. Në detaje kjo funksionon kështu: Kush merr pension nga sigurimi i pleqërisë (AHV), merr për fëmijët e tij si shtesë për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare pension e fëmijëve. Nëse fëmijët gjenden ende në arsimim, ky pension paguhet deri në përfundimin e arsimimit, mirëpo më së gjati deri në mbushjen e moshës 25 vjeç. Lartësia e pensionit të fëmijës është 40% të pensionit të pleqërisë (nga shtylla e parë e sigurimit AHV). Sa i përket vajzës suaj, nga fundi i marsit nuk keni të drejtë përfitimit të mëtejshëm. Ju pensionoheni dhe nuk jeni më tej në marrëdhënie pune. Mirëpo gruaja juaj punon edhe më tej. Ajo për vajzën në arsimim merr shtesat e plota familjare, edhe pse është pjesërisht e punësuar. Parakushti i vetëm është, që paga e gruas suaj të jetë së paku 587 franga në muaj, respektivisht 7050 franga në vit.

Peter Schmid, work, 23.1.2015

Impressum: Bellage zu den Gewerkschaftszettungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariassan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck NZZ Print, Zürcherstrasse 39, 8952 Schlieren | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.